



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 08.09.2014, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektvendimi “Për procedurën paraprake të përzgjedhjes së Anëtarit të Bordit të Mbikëqyrjes Financiare”
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin dhe statusin e organizatës Europiane të së Drejtës Publike”.
3. Projektligji “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.
4. Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të ndryshuar.
5. Projektligji “Për të drejtën e informimit”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Blendi Klosi, Tom Doshi, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Nard Ndoka, Vexhi Muçmataj dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Mark Frroku, Edi Paloka, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Gjovalin Bzheta, Arben Ristani dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Katrin Treska - drejtore e Drejtorisë së Hartimit dhe Analizës së Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Eljona Bylykbashi – përfaqësuese nga Ministria e Drejtësisë

Milena Harito – ministre e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike

Anisa Gjika – këshilltare e ministres e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike

Eralda Cani – këshilltare e Kryeministrit për të Drejtën Publike

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Të nderuar deputetë, fillojmë mbledhjen e komisionit me rendin e ditës të njohur paraprakisht.

Dua të bëj të njohur faktin që ligji nr.9572, datë 3.7.2006, i ndryshuar, miratuar ndryshimet edhe në këtë komision, në nenet 5 dhe 6 i njeh detyrimin Komisionit të Ligjeve për të propozuar një kandidaturë për bordin e AMF-së.

Natyrisht, do të ketë një procedurë, një procedurë publike sipas ligjit dhe në mbështetje të Rregullores, të nenit 19, pika 1, 34 dhe nenit 11. Komisioni do të duhet të respektojë Rregulloren dhe në mbështetje të kërkesave të Rregullores të realizojë një procedurë e cila është bashkëngjitur në këtë vendim. Do të bëjmë një njoftim publik, do të paraqiten kandidaturat në harkun e 10 ditëve dhe komisioni do të bëjë një seancë dëgjimore dhe do të votojë për kandidaturën më të përshtatshme që do ta çmojë për anëtar të bordit të AMF-së.

Biem dakord me procedurën? Është detyrim i ligjit, nuk ka ndonjë përjashtim.

Dakord.

Faleminderit!

Stafi t'i kërkojë sekretares së Përgjithshme të bëjë njoftimin publik që të vazhdojmë pastaj me procedurën në zbatim të kërkesave të ligjit dhe Rregullores së Kuvendit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 08.09.2014, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin dhe statusin e organizatës Europiane të së Drejtës Publike”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Blendi Klosi, Tom Doshi, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Nard Ndoka, Vexhi Muçmataj dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Mark Frroku, Edi Paloka, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Gjovalin Bzheta, Arben Ristani dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Katrin Treska - drejtore e Drejtorisë së Hartimit dhe Analizës së Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Eljona Bylykbashi – përfaqësuese nga Ministria e Drejtësisë

Pika e dytë është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin dhe statusin e organizatës Europiane të së Drejtës Publike”.

Zonja Treska, drejtoreshë e Drejtorisë së Hartimit dhe Analizës së Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë që është e pranishme në këtë mbledhje për të përfaqësuar ministrinë e Drejtësisë, do të na bëjë një përmbledhje të shkurtër, duke qenë se kolegët e kanë në dispozicion projektin dhe kanë kohën e duhur për t’u njohur me të.

Relatori do të bëjë gjithashtu vlerësimin e tij, shkurt gjithashtu, sepse materiali është shpërndarë.

Katrin Treska – Shkurtimisht dua të bëj një prezantim të Organizatës Europiane të së Drejtës Publike, që është themeluar si një organizatë ndërkombëtare që zotëron personalitet të plotë ligjor ndërkombëtar dhe do t’i gëzojë këto kapacitete në varësi të nevojës për ekzistencën e funksioneve të saj dhe përmbushjes së qëllimeve që ajo mund të ketë.

Qëllimi i organizatës është krijimi dhe përhapja e njohurive në fushën e së drejtës publike, duke përfshirë të drejtën publike kombëtare krahasuese dhe europiane, të drejtat e njeriut, të drejtat mjedisore, si dhe promovimin e vlerave europiane me anë të së drejtës publike anembanë botës. Për këtë arsye organizata do të organizojë dhe mbështesë trajnimet shkencore, kërkimore, edukative, trajnuese; mësimdhënie dhe aktivitete të tjera, duke përfshirë të gjitha fushat e njohurive të ndërlidhura me të drejtën publike, si, për shembull, studime ligjore në përgjithësi, shkencat politike dhe ekonomike, marrëdhëniet ndërkombëtare, shkencat administrative, si dhe ndërtimin e institucioneve për aktiviteteve të tjera, duke ofruar ndihmë për institucionet politike në Europë dhe anë e mban botës.

Kjo marrëveshje është nënshkruar në Athinë, më 27 tetor 2004 dhe është nënshkruar nga qeveria e Republikës së Qipros, e Estonisë, e Republikës Helene, e Republikës së Italisë, e Republikës së Moldavisë, Serbisë dhe Malit të Zi.

Për shkak të rëndësisë që paraqet dhe fushës që mbulon, ratifikimi i kësaj marrëveshje është shumë i rëndësishëm për Republikën e Shqipërisë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Treska për prezantimin që i bëtë nismës suaj!

Fjalën e ka zoti Manja, në cilësinë e relatorit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë shumë shkurt do të flas.

Komisioni i Ligjeve e shqyrton këtë projektligj si komision përgjegjës në zbatim të neneve 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

Projektligji në aspektin ligjor është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ndërsa në aspektin procedural ka respektuar të gjitha kërkesat e Rregullores së Kuvendit.

Në përfundim të këtij shqyrtimi, në cilësinë e relatorit, i propozoj Komisionit të Ligjeve miratimin e këtij projektligji dhe kalimin për votim në seancë plenare.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Manja!

Ka pyetje? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord?

Dakord.

Neni 2. Kush është dakord?

Dakord.

Kush është dakord në tërësi?

Miratohet në tërësi projektligji.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 08.09.2014, ora 09:15

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Blendi Klosi, Tom Doshi, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Nard Ndoka, Vexhi Muçmataj dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Mark Frroku, Edi Paloka, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Gjovalin Bzheta, Arben Ristani dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Milena Harito – ministre e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike

Ermonela Felaj – ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Kuvendin.

Anisa Gjika – këshilltare e ministres së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike

Eralda Cani – këshilltare e Kryeministrit për të Drejtën Publike

Fatmir Xhafaj – Fillojmë shqyrtimin e projektligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Të ftuar për të prezantuar projektin kemi zonjën Milena Harito, ministre e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, dhe zonjën Ermonela Felaj, ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Kuvendin.

Faleminderit, zonja Felaj!

Faleminderit, zonja Harito!

Fillimisht do të dëgjojmë një prezantim nga përfaqësuesit e qeverisë, besoj nga zonja Harito, pastaj fjalën do ta marrë relatorja, zonja Hysi.

Milena Harito – Mirëmëngjesi!

Faleminderit, zoti Xhafaj!

Projektligji “Për konsultimin publik” ka qenë një nismë e propozuar nga shoqëria civile, veçanërisht nga “Soros”, dhe e parashikuar në planin e parë të veprimit të hartuar nga qeveria shqiptare në kuadrin e nismës “Open government”, që është një nismë e Presidenti Obama disa vite më parë, ku qeveria shqiptare ka aderuar. Ky projektligj ishte depozituar në Kuvend përpara 23 qershorit të vitit të kaluar dhe është një nga ligjet që Kuvendi e ktheu për rishikim.

Ajo që dua të theksoj këtu është që edhe pse ishte paraqitur si nismë nga shoqëria civile, ky projektligj nuk ishte konsultuar me grupet e ndryshme të interesit. Kështu që qeveria shqiptare vendosi të ndërmarrë një proces të ri konsultimi me shoqërinë civile, me grupet e interesit. Ishte një proces i gjatë, që pati disa etapa, disa evenimente publike, ku u morën të gjitha komentet e grupeve të interesit, të cilat i diskutuam gjerësisht me ta. Është një ligj shumë i debatuar, por e rëndësishme është që është një ligj që futet për herë të parë në këtë formë. Në kuptimin që kemi një ligj kuadër, i cili detyron të gjitha ministratë në këtë rast, të gjitha institucionet, që çdo ligj të ri ta konsultojnë në mënyrë të detyrueshme dhe ta publikojnë në një vend të centralizuar, pra në një regjistër elektronikë, ku gjithkush ka akses. Ky ligj vendos afate kohore dhe detyrime administrative. Pra në qoftë se ky proces nuk respektohet dhe ka detyrime administrative, grupet e ndryshme të interesit mund ta çojnë në Gjykatën Administrative. Gjithashtu vendos për herë të parë funksionin e koordinatorit për këtë detyrim. Pra, është e

rëndësishme të kuptohet që futen për herë të parë funksione të reja për administratën. Do të doja gjithashtu të thosha që është një ligj më i avancuar edhe për një pjesë të vendeve të Bashkimit European. Jo të gjithë kanë një ligj kuadër të kësaj natyre, por ne mendojmë që për nivelin e zhvillimit të demokracisë sonë është e nevojshme që ta bëjmë këtë hap dhe për këtë arsye e propozojmë këtë ligj.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti kryetar i Komisionit të Ligjeve!

Mirëmëngjesi të gjithëve!

Prezenca e ministrit të Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin në mbledhjen e sotme të Komisionit të Ligjeve lidhet me faktin se ky projektligj, projektligji “Për konsultimin publik”, lidhet drejtpërdrejt me fushën e përgjegjësiave të ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin. Një ndër përgjegjësitë e këtij ministri është pikërisht garantimi i realizimit të procesit të transparencës, i procesit të këshillimit me shoqërinë civile, me të gjitha grupet e interesit që projektligje të caktuara, projektakte të caktuara etj. i prekin.

Mua më vjen mirë që kemi mundësinë ta diskutojmë këtë projekt pikërisht në Komisionin e Ligjeve, sepse kam parasysh se edhe më parë ky komision ka insistuar vazhdimisht që çdo projekt që është kaluar në të, të kalojë edhe fazën e konsultimit me shoqërinë civile apo me grupet e interesit. Kujtoj që edhe gjatë kohës që ne kemi qenë në opozitë, kemi këmbëngulur fort që projektet, me qëllim që të rrisin cilësinë e tyre dhe të realizojnë pritshmëritë e grupeve që prekin, të marrim edhe mendimin e tyre. Njëkohësisht, besoj se me këtë projekt, sot ne realizojmë edhe një objektiv të programit tonë qeveritar, siç është ai i një qeverisjeje të hapur. Është një projekt që, më së fundi, nuk do ta lërë procesin e konsultimit e të këshillimit me grupet e interesit të kryhet në mënyrë vullnetare, por një proces që tanimë do të gjejë një normim të shprehur në këtë projekt.

Ministrja Harito foli pak më shumë në detaje për rregullat e detyrimet që përcakton ky projektligj. Besoj se gjatë shqyrtimit nen për nen do të kemi rast që t'i

avancojmë akoma më tepër diskutimet tona, duke ruajtur qëndrimin që ne jemi të hapur të pranojmë çdo diskutim që bëhet në lidhje me këtë projekt. Ju faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Felaj!

Fjalën e ka zonja Hysi, relatore.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar! Faleminderit, zonja Harito! Faleminderit, zonja Felaj!

Në fakt, projektligji për njoftimin dhe konsultimin publik vjen në Komisionin e Ligjeve. Ne jemi komisioni përgjegjës i shqyrtimit të tij. Sikurse e tha edhe zonja Harito, projektligji ka kohë që është depozituar në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni i Ligjeve, me kërkesë të kryetarit të Komisionit, ka bërë një konsultim publik të gjerë. Pra, ne kemi filluar ta zbatojmë ligjin, por ligji ende nuk është miratuar. Për transparencë, kanë shprehur opinionet e tyre të detajuara: OSBE, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrotjtjen e të Dhënave Personale, Fondacioni i Hapur për Shoqërinë Civile dhe Qendra për Nismat Ligjore e Qytetare. Ndërkohë, projektligji është i afishuar edhe në faqen e internetit të Kuvendit të Shqipërisë.

Projektligji është nismë e Këshillit të Ministrave. Është nismë që duhet përshëndetur. Është një hap shumë i rëndësishëm në tre drejtime kryesore. Në radhë të parë është pjesë e të drejtës së informimit, pra njoftimi dhe konsultimi publik nuk duhet parë thjesht si një detyrim që ka qeveria, por është një përmbushje e të drejtës për informim, që kanë qytetarët.

Së dyti, njoftimi dhe konsultimi publik është pjesë e procesit të ligjbërës dhe në këtë kuadër do të kontribuojë më mirë që publiku të marrë pjesë në procesin e politikëbërjes e të vendimmarrjes për çështje me interes të lartë publik.

Së treti, kjo nismë e qeverisë e bën qeverinë më transparente. Pjesëmarrja e publikut jo vetëm që do të ndikojë në hartimin më të mirë të ligjeve, por edhe në zbatimin më të mirë të tyre, duke qenë se ato do të marrin pjesë që në hapat e para të hartimit të ligjeve. Gjithashtu, projektligji nxit dhe siguron jo vetëm njoftimin dhe konsultimin e publikut e të palëve të interesuara, por njëkohësisht e rregullon këtë proces në mënyrë institucionale. Për të gjithë ata që na dëgjojnë, unë do të ndalesha shkurtimisht në shtatë risitë e këtij ligji, të cilat, për të thënë të drejtën, kjo maxhorancë i ka zbatuar qëkurse ka

ardhur në qeverisje, pa pasur ligj. Por tashmë, një pjesë të këtyre procedurave të transparencës gjenden të mishëruara në ligj.

Së pari, krijohet regjistri elektronik për njoftime dhe konsultime. Pra, çdo qytetar ka të drejtë të njohë në çdo kohë projekt-aktet, komentet dhe rekomandimet që bëhen për to.

Së dyti, çdo organ publik cakton një person në pozicionin e koordinatorit të njoftimeve e të konsultimit publik. Kjo është gjë shumë e rëndësishme, veçanërisht për gazetarët, por edhe për qytetarët që kanë interesa për përmbajtjen e një projektligji apo të një projekt-akti tjetër.

Së treti, projektligji përcakton rregullat procedurale, se si mund të konsultohen grupet e interesuara, por edhe se si mund të shprehin opinionet dhe mendimet e tyre. Ajo që është shumë e rëndësishme, ka afate brenda të cilave personat dhe palët e interesuara mund të bëjnë, të marrin njoftimin e të japin rekomandimet dhe komentet e tyre për projekt-aktin.

Gjithashtu, është risi që projekt-akti, së bashku me komentet e rekomandimet, bëhen publike. Në rast se pranohet, bëhet e qartë nga autoriteti publik se cilët nga këto komente e rekomandime janë pranuar, cilat nga rekomandimet e komentet nuk janë pranuar dhe pse nuk janë pranuar. Kjo është pjesë shumë e rëndësishme, e cila deri më sot ka munguar, pavarësisht se ne, në Komisionin e Ligjeve e bëjmë për çdo ligj dhe në relacionet tona sjellim mendimin e palëve, e grupeve të interesuara të palëve, kjo nuk bëhet nga çdo lloj institucioni.

Dhe, e fundit fare, parashikohet e drejta e ankimit në organin publik ose në gjykatë. Pra, nuk është një ligj deklarativ, që bëhet për të treguar se qeveria është transparente, por ka sanksione reale për mosrespektimin e kësaj të drejte.

Sikurse e tha edhe ministrja Harito, jo të gjitha vendet e kanë këtë ligj. Pra, Shqipëria po hedh një hap shumë të guximshëm. Ajo ku unë do të doja të ndalesha, meqenëse është risi, por nuk do të ndalem nën për nën, përderisa ne do ta diskutojmë në vijim, grupet që do të përfshihen në konsultim janë të gjithfarëllojshme, duke filluar që nga publiku i thjeshtë, OJF-të, ekspertët, grupet e interesit. Gjithashtu, palët e interesuara janë jo vetëm shtetas shqiptarë, por edhe shtetas të huaj, janë organe publike dhe

jopublike, persona fizikë dhe persona juridikë. Pra, po të shikoni, grupi i personave që përfshihet në konsultim është shumë i gjerë.

Së dyti, mënyra e njoftimit është jashtëzakonisht e avancuar. Krahas regjistrit elektronik, dhe besoj se të gjithë kanë akses në këtë regjistër elektronik, do të ketë edhe forma të tjera të informimit të publikut: posta elektronike, lajmërimi publik, lajmërimi në mediet audiovizive kombëtare, rajonale lokale, si dhe në gazeta.

Pra, po të shikohet, të gjitha format e mundshme të komunikimit publik janë të parashikuara në ligj. Risia është se do të ketë konsultime me shkrim dhe takime të hapura publike, të cilat do të evidentohen. Pra, nuk do të jenë takime, të cilat bëhen për të qenë i pranishëm në medie, por do të ketë shënime, procesverbale dhe mendime konkrete, të cilat do të reflektohen.

Gjithashtu, sipas ligjit, informacioni që do të bëhet publik për konsultim nuk është vetëm përmbajtja e projekt-aktit, por do të publikohet. Kjo është risi jashtëzakonisht e mirë dhe janë për t'u përshëndetur të gjitha planet vjetore që kanë organe publike që lidhen me procesin e ligjbërjes. Kështu që, të gjithë gazetarët, të gjithë njerëzit e interesuar, që na ndjekin neve, por edhe qytetarët, nuk kanë pse të rendin e të luten për të marrë projekt-aktet apo të dinë se kur do të vijë një projektligj në parlament, por të gjitha këto do të jenë që në fillim të vitit, të afishuara në faqet e autoritetit publik. Në këtë mënyrë, do të keni kohë edhe ju si gazetarë, por edhe qytetarët, që të konsultohen, të mbledhin opinione e të bëjnë investigime për nismat që do të marrë organi publik.

Gjithashtu, ajo që është risi, është edhe momenti i përfshirjes së palëve të interesuara. Ka dy momente kur mund të përfshihen palët e interesuara: në kategori të veçanta ligjesh, që vlerësohen me interes të lartë publik, palët mund të ftohen që në fillim, pa u ndërmarrë nisma, për të mbledhur mendime e opinione para se nisma të ndërmerret. Rasti i dytë është kur nisma është ndërmarrë, projektligji hidhet për diskutim dhe mbledhen mendime, opinione e rekomandime për një nismë të marrë.

Gjithashtu, periudha e njoftimit dhe afatet e dorëzimit të opinioneve e rekomandimeve janë të parashikuara në ligj.

Të nderuar kolegë, është një pikë të cilën, të gjithë personat, autoritetet kushtetuese dhe institucionet e shoqërisë civile e organizatat ndërkombëtare në Shqipëri e kanë vlerësuar si një pikë e projektligjit që ka një avancim shumë më të madh nga

projekti i parë që ishte paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë. I gjithë ligji ka ndryshuar jashtëzakonisht shumë. Është më i avancuar. Megjithatë, ka nisma e modele të ndryshme lidhur me afatet që mund të lihen për konsultimin e ligjeve.

Ndoshta në diskutimin nen për nen ne mund ta diskutojmë se si mund të bëjmë diferencim për disa ligje që kanë interes të madh publik ose që mund të jenë voluminozë dhe kërkohet një ekspertizë e cilësuar.

Së fundi, të nderuar kolegë, unë do të doja të thosha se ky projektligj, në aspektin ligjor është në përputhje me Kushtetutën e me legjislacionin në fuqi. Në aspektin procedural është paraqitur në përputhje me rregulloren e Kuvendit dhe shqyrtohet në përputhje me këtë rregullore. Si relatore e vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij ligji. E mbështes nismën e Këshillit të Ministrave dhe ju ftoj juve për ta miratuar në parim.

Gjatë shqyrtimit nen për nen rezervoj pastaj të drejtën për të ndërhyrë për rregullimin e ndonjë dispozite të caktuar. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Mbasi kemi dëgjuar përfaqësuesit e qeverisë, kemi dëgjuar relatorin, dokumentet e tjera janë në dispozicionin tuaj, përfshi edhe vetë iniciativën.

Ka pyetje?

Po, zoti Qefalija!

Xhemal Qefalija – Faleminderit, zoti kryetar!

Pyetja ime konsiston në këtë: ligji është një gjë shumë e mirë, është një nismë, por unë do të isha i interesuar për të pasur informacion se cili është autoriteti që kontrollon, drejton dhe menaxhon punën e gjithë këtyre koordinatorëve që do të jenë në organet publike. Do të jenë drejtuesit e institucioneve, apo do të ketë një strukturë tjetër që do të menaxhojë gjithë aktivitetin e koordinatorëve? Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Qefalija!

Është zonja ministre që do ta marrë fjalën, apo këshilltarja? Po.

Anisa Gjika – Përsëendetje! Në politikë nuk është parashikuar një strukturë e lartë, e cila do të koordinojë gjithë punën e koordinatorëve. Është institucioni, i cili do t'i caktojë rolin e koordinatorit një anëtar të grupit të punës, për shembull, që të hartojë projekt-aktin, i cili do të kujdeset për plotësimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga

pozicioni i koordinatorit. Pra nuk ka një strukturë të pavarur jashtë institucionit, e cila do të drejtojë koordinatorët. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, faleminderit! Pyetje të tjera?

Ka pyetje të tjera?

Nuk ka pyetje të tjera.

Kam unë vetëm një pyetje. Meqenëse ju, zonja Ministre – edhe relatorja e ritheksoi – e quani këtë një hap shumë të avancuar, të paktën, edhe këtu do t’ia kalokemi Gjermanisë, tani tek neni 4, pika “c” aktet ku nuk zbatohet ky proces, keni një kufizim me aktet administrative me karakter normativ dhe aktet administrative individuale. A mund të më thoni se cila është arsyeja që duhet ta bëni këtë gjë, sidomos për akte me karakter normativ?

Milena Harito – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Keni shumë të drejtë, sepse kjo është një çështje që është ngritur nga të gjitha grupet e interesit dhe është një çështje shumë e debatuar, ka qenë një nga arsyet përse procesi ka zgjatur.

Siç e thatë me të drejtë, është një hap realisht i madh dhe për këtë arsye ne, pas debateve dhe duke parë realitetin e volumit të punës të akteve ligjore dhe të akteve nënligjore, konstatojmë se sot, në këtë stad ku jemi, ku futen këto funksione të reja, është e pamundur fizikisht të aplikohet kjo procedurë për të gjitha aktet nënligjore. Pra, aktet nënligjore, përpara se të vinim këtu nxorëm, disa të dhëna, unë që jam ministre e Shtetit pra, mesatarisht kam më pak akte nënligjore se sa kolegët e mi, kam pasur 5 akte nënligjore në muaj gjatë vitit të kaluar, gjë që do të thotë se fizikisht në këtë stad, pra kur funksioni ende nuk është i absorbuar nga administrata, duket shumë e vështirë që këtë gjë ta aplikojmë edhe në aktet nënligjore. Prandaj sugjerojmë të bëhet ky hap i parë sigurisht për ligjet që janë shumë më të rëndësishme në normativën e akteve, ta absorbojë administrata këtë funksion, sigurisht, të promovohet edhe gjithë pjesëmarrja e shoqërisë civile, të shikojmë si do të funksionojë dhe në një moment të mëtejshëm të shikojmë më tej.

Fatmir Xhafaj – Mirë, ngelet çështje për t’u diskutuar kur ta shikojmë nen për nen. Unë do të vazhdoj ta elaboroj më shumë këtë, kjo është e drejta ime si deputet.

Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Ka diskutime?

Zoti Qefalia, urdhëroni!

Xhemal Qefalia – Nisur edhe nga marrja e përgjigjes që pata nga zonja, normalisht mendoj se ligji në tërësi është një ligj shumë i arrirë, është një gjë që tregon transparencën e punës së qeverisë, një aspekt shumë i rëndësishëm, por duke vendosur një risi të re në aktivitetin për të bërë publik të gjithë aktivitetin e gjithë organeve ligjzbatuese, e quaj pa vend që gjithë ky organizim deri në detaje në të gjitha organet ligjzbatuese të ketë koordinatore dhe të mos ketë drejtim. Kjo do të thotë që të lihen në dorë spontane detyrat që kryen koordinatori për informacionin publik, ose më saktë, do të thotë të jetë një organ i ri i ngritur, pa kokë, pa drejtim, pa menaxhim. Do të isha i mendimit, zonja Ministre, që të rishikohet, sipas mendimit tim personal, që kjo nismë kaq e mirë të mos dështojë për një organizim të tillë, për një drejtim dhe një menaxhim, i cili të shkojë deri në detaje, deri në organizmin më të vogël publik.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Qefalia!

Besoj se do të jetë në vëmendjen e relatores shqetësimi juaj, por edhe ministrja e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin besoj se e ka kuptuar që në këtë rast mund të ketë një pikë takimi me pyetjen, sipas meje.

Ka diskutime të tjera?

Nuk ka.

Faleminderit, për mirëkuptimin!

Kush është dakord në parim?

Dakord.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Para se të kalojmë në dy pikat e tjera të rendit të ditës, mendoj se duhet ta mbyllim këtu këtë pikë të rendit të ditës për dy arsye:

Arsyeja e parë, besoj se është në interes që kolegëve t'u japim kohë për t'u njohur me të gjitha komentet e bëra nga institucionet ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile, t'u japim kohë përfaqësuesve të qeverisë që së bashku me relatorët të diskutojnë nën për nën, dhe njëkohësisht ta shohim këtë të harmonizuar edhe me

legjislacionin kuadër në këtë fushë, veçanërisht me ligjin, i cili ka të bëjë me funksionimin e Këshillit të Ministrave. Besoj se biem dakord për këtë gjë.

Faleminderit, zonjat Ministre, për prezencën, shpresoj që të rishihemi përsëri për këtë dhe për gjëra të tjera!

Gjithë të mirat!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 08.09.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Blendi Klosi, Tom Doshi, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Nard Ndoka, Vexhi Muçmataj dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Mark Frroku, Edi Paloka, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Gjovalin Bzheta, Arben Ristani dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Katrin Treska - drejtore e Drejtorisë së Hartimit dhe Analizës së Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Eljona Bylykbashi – përfaqësuese nga Ministria e Drejtësisë

Fatmir Xhafaj - Tani, kemi dy votime në parim. Për shkak të kuorumit, nuk i kemi realizuar. Votimi i parë është për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. Datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar””. Kemi bërë paraqitjen e projektit, pyetjet, diskutimet, kemi të domosdoshme të bëjmë votimin në parim për shkak se nuk kemi pasur kuorum në mbledhjen e mëparshme.

Kush është dakord në parim? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me një votë kundër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 08.09.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për të drejtën e informimit.”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Blendi Klosi, Tom Doshi, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Nard Ndoka, Vexhi Muçmataj dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Mark Frroku, Edi Paloka, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Gjovalin Bzheta, Arben Ristani dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Katrin Treska - drejtore e Drejtorisë së Hartimit dhe Analizës së Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Eljona Bylykbashi – përfaqësuese nga Ministria e Drejtësisë

Fatmir Xhafaj – Kemi, gjithashtu, votimin në parim për projektligjin “Për të drejtën e informimit”, të cilin e kemi shqyrtuar në seancën e javës së kaluar, kemi bërë prezantimin, pyetjet, debatin përkatës. Edhe këtë, për shkak të kuorumit, nuk e kemi votuar në parim dhe do t’ju ftoja për ta votuar në parim për t’i hapur rrugë si projektligjit të mëparshëm, diskutimit nen për nen.

Kush është dakord në parim me iniciativën për projektligjin “Për të drejtën e informimit”?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për të drejtën e informimit”.

Të dyja këto projektligje, së bashku me konsultimin publik, së bashku me ligjin “Për Avokatin e Popullit”, do të jenë pjesë e një pakete që do të duhet ta shqyrtojmë në një kohë të mëvonshme, pasi të fillojmë dhe procesin për shqyrtimin e ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

E mbyllim këtu këtë mbledhje komisioni.

Faleminderit për prezencën!

Faleminderit për kontributin!

Mirutakofshim nesër në orën 10:00, sipas kalendarit!